



Prishtinë, 13 prill 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_965\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe Nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 21.12.2017 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja "Danske Commodities Kosovo" SH.P.K., Adresa: Q.Pejton, Rr.Mujo Ulqinaku Nr.5 Ap 4, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 13 prill 2018, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **VAZHDOHET** Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "Danske Commodities Kosovo" SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li\_39/17 për periudhën nga data 22.04.2018 deri 21.04.2023.

## Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 21.12.2017 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike nga ndërmarrja "Danske Commodities Kosovo" SH.P.K.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave/dëshmive të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të këtij aktiviteti dhe ka kërkuar dokumente shtesë, të cilat janë sjellë në Rregullator.
- o Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara sipas aplikacionit, Rregullatori ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



II. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **"Danske Commodities Kosovo" SH.P.K.**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i Rregullatorit**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar